



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	713
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	02	Data Datum Date	11.09.2025
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues / Upravni Odbor/ Steering Committee

Nr. 01/ **713** /2025
Datë: 11/09/2025

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 i Rregullores nr. 02/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe nenit 41 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më datë 11 shtator 2025 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore Prishtinë me nr. A.nr.236/2025 e datës 05.09.2025 drejtuar Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Akademisë së Drejtësisë për plotësim ndryshimin e vendimit për propozimin e mentorëve për prokurorët me mandat fillestar.
2. Plotësohet dhe ndryshohet pika 2 e vendimit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë nr. 01/16/2025 i dt. 10.01.2025 me të cilin caktohen mentorët për prokurorët e sapoemëruar (gjenerata XI), ashtu që në vend të prokurores znj. Fikrije Sylejmani caktohet si mentor prokurorja znj. Fatmire Cacaj.
3. Obligohen mentorët t'i përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës sipas kërkesës nr. KPK/07/2025 të datës 08 janar 2025 i ka propozuar për emërim Akademisë së Drejtësisë listën e mentorëve për prokurorët me mandat fillestar (gjenerata XI).

Këshilli Drejtues i AD-së, listën e propozuar të mentorëve e ka miratuar përmes procedurës qarkulluese më datë 10 janar 2025, pjesë e së cilës ishte edhe prokurorja znj. Fikrije Sylejmani si mentorë e caktuar në Prokurorinë Themelore Prishtinë.

Me rastin e pensionimit të prokurores Fikrije Sylejmani, Prokuroria Themelore Prishtinë sipas kërkesës A.nr.236/2025 së datës 05 shtator 2025 ka propozuar që si mentor i prokurorit Malart Kuçi të caktohet prokurorja Fatmire Cacaj.

Ky plotësim ndryshim i vendimit është bërë për të siguruar vazhdimësinë e procesit të trajnimit praktik për prokurorët me mandat fillestar.

Fejzullah Rexhepi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv të AD-së
- Këshillit Prokurorial të Kosovës
- Mentorëve të angazhuar
- Udhëheqëses së Divizionit në PTF
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë